



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



Save the Children

Një botë ndryshe

Buletin i përtremuajshëm i organizatës “MEDPAK”

Për më shumë informacion kontaktoni në tel me nr 042345028 dhe 0693577247

[illegible]**MEDPAK**

Adresa: Rruha "Sh. Ishmi", Pallati 38,
Shkalla 1, Apt. 2, Tiranë
Tel: +355 4 23 45 028
Mobile: +355 69 3577 247 / +355 68 2578 002
E-mail: info@medpak.org
website: www.medpak.org
 @MEDPAK.ALBANIA

Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7,
ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë, Albania
Tel:+355 4 2261840 / 2261929
E-mail: info.albania@savethechildren.org
<https://albania.savethechildren.net>

 Savethechildrenal
 SaveChildrenAlb

Në fund të vitit të dytë të projektit “Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri” (Korrik 2014 –Qershor 2016)

Projekti “Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri” shtrihet në periudhën tre vjeçare (Korrik 2014- Qershor 2017) dhe synon krijimin e aksesit dhe arsimimin në shkolla gjithëpërfshirëse të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë në shtatë rajone të Shqipërisë: Gjirokastrë; Korçë; Elbasan; Durrës; Burrel; Peshkopi dhe Vlorë. Ky projekt financohet nga Kooperacioni Italian i Zhvillimit/Ministria e Jashtme Italiane dhe zbatohet nga **Save the Children** në partneritet me shoqatën **Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara** (MEDPAK), Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) në Korçë, Elbasan, Durrës, Burrel, Peshkopi, Gjirokastrë dhe Vlorë, si edhe me njësitë e qeverisjes vendore në këto rajone.

Projekti “Arsim Gjithëpërfshirës” ishte një nismë ambicioze, vizionare e bazuar në përqasjen e vlerësimit të aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut/ fëmijëve dhe me synim të qartë të realizimit të një procesi reformues të politikave, kulturave dhe praktikave ekzistuese. Përballja me realitetin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, vlerësimi i shkollave speciale si alternativa më e mirë e arsimimit të tyre, kultura mbizotëruese e mospranimit të këtyre fëmijëve në kopshte e shkolla etj, ishin paralajmëruese të një pune sfiduese.

Ky projekt mbështetet në Objektivat strategjike të MASH dhe qeverisë shqiptare për krijimin e një **shkolle cilësore** me synim krijimin e një **shoqërie gjithëpërfshirëse**. Komuniteti shkollor nxënës, mësues dhe prindër po përfitojnë nga lehtësimi i punës për krijimin e shkollave dhe kopshteve gjithëpërfshirëse. Stafet e DAR-ve në: Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Burrel, Durrës, Peshkopi dhe Elbasan kanë rritur kapacitetet e tyre në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinore, për vlerësimin e nevojave arsimore të nxënësve.

Aktivitetet kryesore të këtij projekti janë:

- ✓ Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, në klasa dhe grupe bashkë me moshatarët e tyre bazuar në PEI të ndërtuar për secilin prej tyre (në projekt janë përfshirë 7460 nxënës të 14 shkollave ku 316 janë fëmijë me AK e VN dhe 7 kopshte janë përfshirë 1573 fëmijë prej të cilëve 41 janë me AK dhe VN);
- ✓ Ngritja dhe trajnimi i komisioneve multidisiplinore në DAR/ZA (Janë trajnuar 52 specialistë të kurrikulës në DAR/ZA, psikologë, punonjës socialë, mësues, pjesë e komisioneve të vlerësimit);
- ✓ Organizimi dhe zhvillimi i kurseve të trajnimit me punonjës të arsimit për zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse;
- ✓ Organizimi dhe zhvillimi i kurseve të trajnimit me punonjës të shërbimit psiko-social si pjesë e rëndësishme e komisionit;
- ✓ Takime formale dhe jo formale me prindër për ti bërë edhe ata pjesë aktive të punës në shkollë dhe kopsht;
- ✓ Shkëmbim eksperiencash midis prindërve, mësuesve që punojnë direkt me fëmijë

- me aftësi të kufizuar në klasa gjithëpërfshirëse me kolegë të tyre në rajonet ku është zbatuar më parë ky projekt;
- ✓ Pajisja e shkollave me bazë materiale didaktike për të mbështetur edukimin e fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- ✓ Dokumentimi i të dhënave statistikore në mënyrë periodike, për të vlerësuar arritjet dhe nevojat e fëmijëve në vite.

Arritjet kryesore gjatë zbatimit të këtij projekti

1. Një nga përparësitë e projektit ishte ngritja e kapaciteteve të mësuesve duke ofruar trajnime me module të akredituara në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe të Korçës. Në të shtatë rajonet janë trajnuar 234 specialistë të edukimit dhe mësues. Mësuesit janë aktorët që përbëjnë hallkën më të rëndësishme në zbatimin e procesit gjithëpërfshirës. Suksesi i nxënësve lidhet pashmangshmërisht me përgjegjshmërinë e tyre, nivelin e njohurive dhe aftësive në mësimdhënie si dhe efektivitetin e zbatimit të ligjit. Trajnimet me mësuesit kanë pasur në fokus zhvillimet e fundit mbi çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar, karakteristikat e çrregullimeve dhe aftësisë të kufizuar si dhe mënyrat dhe përjasjet për të mbështetur dhe lehtësuar arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta arsimore në shkolla të zakonshme.

2. Modulet e trajnimeve të përdorura me specialistë që punojnë direkt me fëmijët me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë, janë të pasqyruara përmbledhtazi më poshtë në baze të tematikave të trajnimit.

✓ *Trajnim me specialistët e komisionit të DAR për Klasifikimin Ndërkombëtar të funksioneve për fëmijët dhe të rinjtë.*

Specialistë të komisioneve me bazë në Drejtoritë Arsimore u trajnuan në tre sesione (8 ditë trajnim) për Klasifikimin Ndërkombëtar të funksioneve të fëmijëve dhe të rinjve (ICF-CY), me qëllim realizimin e vlerësimeve sa më profesionale bazuar në instruenta që përdoren në nivel ndërkombëtar.

✓ *Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm në Shqipëri.*

Modul trajnimi i përshtatur për punonjësit e arsimit, i fokusuar tek llojet e aftësisë së kufizuar dhe vështirësive në të nxënë dhe karakteristika të sjelljeve të këtyre fëmijëve. Materiali vijon me informacione për mësuesit për evidentimin e nevojave dhe burimeve të mbështetjes për një shkollë gjithëpërfshirëse, roli i mjedisit social dhe efekti i tij tek të nxënëit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, probleme të zhvillimit të fëmijëve dhe i orienton ata lidhur me bashkëpunimin me specialistët e tjerë dhe prindërit e tjerë për të mundësuar një edukim cilësor dhe një klimë pozitive të nxënë.

✓ *Të kuptojmë dhe menaxhojmë sjelljet e fëmijëve me autizëm në klasa gjithëpërfshirëse.*

Trajnimi u përqendrua tek njohja me spektrin e autizmit, karakteristikat e tij, vështirësitë me të cilat hasen mësuesit në menaxhimin e sjelljeve të fëmijëve me autizëm në klasë. Mësuesit u informuan për përdorim i teknikave të përforsimit pozitiv si mjet për motivimin e nxënësve me autizëm, dhe aspekte të tjera të punës së individualizuar dhe mënyrave për përfshirjen e tyre efektive në klasë.

✓ *Mësimdhënia për nxënësit me vështirësi në të nxënë.*

Ky modul përfshin informacion të plotë në lidhje me llojet e vështirësive në të nxënë që ndeshen më shpesh tek fëmijët e moshës shkollore, karakteristikat e tyre, vështirësitë me të cilat hasen këta fëmijë në procesin e mësimin dhe mënyrave se si mësuesit duhet të ndërtojnë punën në varësi të llojeve të vështirësive në të nxënë.

3. Trajnime me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë aktorët kryesorë të gjithëpërfshirës. Ata ndeshen me vështirësi e pengesa serioze gjatë rritjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre. Mungesa e njohurive të mjaftueshme rreth karakteristikave të zhvillimit të fëmijëve, mënyrave se si duhet të përballojnë emocionet e si duhet të mbështesin proceset gjithëpërfshirëse nxori në pah dukshëm nevojën e trajnime të prindërve. Trajnimet me prindër kanë pasur në fokus adresimin e të gjitha nevojave dhe vështirësive të tyre për të edukuar fëmijët dhe shtuar informacionin se si duhet të punojnë me fëmijët e tyre dhe si mund të ndihmojnë në realizimin e proceseve gjithëpërfshirëse në kopshte, shkolla e shoqëri.

✓ *Njohja me legjislacionin dhe të drejtat prindërore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.*

Moduli i këtij trajnimi rriti kapacitetet e mësuesve dhe specialistëve të tjerë në lidhje me elementët strukturore të PEI, arsyet se pse është i domosdoshëm, si hartohet, çfarë duhet të përmbajë ky dokument dhe se si mund të sigurohet zbatimi efikas i këtij plani. Materiali ofron modele të ndryshme planesh edukative individuale dhe shembuj konkretë planesh të plotësuar të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

✓ *Çfarë duhet të dimë lidhur me procesin e rritjes dhe edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë.*

Ky modul synon të rrisë nivelin e njohurive dhe aftësive të prindërve lidhur me dilemat e rritjes dhe socializimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë. Përmes informacionit të këtij manuali, prindërit ndërgjegjësohen të praktikojnë teknika të përshtatshme për të nxitur dhe zhvilluar aftësitë dhe shprehitë e pavarësisë e autonomisë së fëmijëve dhe të kuptojnë rëndësinë e krijimit të një mjedisi të përshtatshëm, që ndihmon dhe stimulon një zhvillim të mirë mendor, social e emocional të fëmijëve.

✓ *Lobimi dhe advokacia*

Lobimi dhe advokacia, është një tjetër modul i përgatitur për prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara si një grup i rëndësishëm interesi që mund të influencojnë politikat sociale për të arritur objektiva të interesit kolektiv. Prindërit janë aftësuar të evidentojnë strategji efikase advokuese e lobuese për të modeluar perceptimin publik mbi çështjet të aftësisë së kufizuar, apo ndërvepruar me autoritetet publike.

4. Realizimi i aktiviteteve sensibilizuese edhe advokuese

Këto aktivitete të zhvilluara në kuadrin e projektit dhe me mbështetjen e tij kanë qenë të shumta e të llojeve të ndryshme. Qeveritë e nxënësve, si struktura të rëndësishme të ndryshimeve dhe të vendimmarrjes në shkollë, kanë qenë iniciatorë dhe partnerë të aktiviteteve advokuese në shkolla. Aktivitete advokuese për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

janë zhvilluar edhe në nivel organizimesh të rëndësishme në qytete. Me rasatin e ditëve ndërkombëtare janë shpërndarë tek qytetarët fletëpalosje dhe materiale informuese për prindër dhe mësues, të cilat përcjellin mesazhe respekti ndaj të drejtave të fëmijëve si të kufizuara pa asnjë dallim, duke i vlerësuar ata si qenie me të drejta të plota për arsim, argëtim, kujdes të veçantë, trajtim në përputhje me mundësitë dhe aftësitë e tyre etj.



5. Një element tjetër i këtij projekti në kuadrin e krijimit të kushteve të favorshme për të lehtësuar arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara ishte edhe pajisja **me bazë materiale e një mjedisi brenda shkollës**. Pajisja me bazë materiale didaktike për kopshtet është zgjidhur dhe adresuar më mirë në raport me kërkesat që ka shkolla për mjete didaktike, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara.

6. Janë kryer vlerësimet për aksesibilitetin e shkollave dhe kopshteve të përfshira në këtë projekt me qëllim ndërhyrjen në infrastrukturën e shkollës për të kryer adaptimet e nevojshme për të siguruar akses për arsimim të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për këto ndërhyrje.




7. Një aktivitet i rëndësishëm në fund të vitit të dytë të këtij projekti është edhe **trajnimi i mësuesve ndihmës**, një figurë e re në arsimin bazë e cila ka dalë si nevojë e zbatimit të ligjit për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme. Kjo figurë është e njohur tashmë pothuaj në gjithë vendin. Bashkëpunimi me MAS në këtë rast bëri që rreth 160 specialistë të edukimit, prej të cilëve 135 mësues ndihmës dhe të tjerët mësues që kanë të përfshirë në klasat e tyre nxënësit me aftësi të kufizuara, të merrnin 3 ditë trajnime bazuar në dy modulet :

- 1) menaxhimi i klasës kur ka fëmijë me vështirësi në të nxënë dhe
- 2) menaxhimi i klasës kur ka fëmijë me autizëm.

Zbatimi i projektit arsim gjithëpërfshirës, synon të adresojë disa nga problemet me të cilat ndeshet arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë si dhe të krijojë një model, i cili duhet të replikohet dhe përmirësohet më tej për të përmbushur standardet e nevojshme të gjithëpërfshirës së personave me aftësi të kufizuara në edukim dhe shoqëri.

Mbresa.....

Dita më e bukur që kam kaluar me vëllain tim.



Ka shumë ditë në vit, që na bëjnë të ndihemi të lumtur, të kënaqur apo të plotësuar. Nuk ndodh shpesh, por aq rrallë sa ndodh akoma me mirë sepse kështu kuptojmë vlerën e lumturisë. Pa ditët me shi nuk do kuptonim kënaqësinë që na falin ditët me diell.

Në jetën time unë kam fatin të kem afër meje dikë të veçantë që është gjysma ime, binjaku im Vëllai. Them binjakun pasi ngjashmëria jonë në tipare është e theksuar edhe pse ne nuk jemi të tillë realisht. Ai është vërtet një person i veçantë. Nuk e ka këtë veçanti nga çrregullimi që ai mbart Autizmi. Por sepse ai është vërtet i tillë, thjesht në mënyrën se si është ndërtuar karakteri dhe fiziku i tij. Unë të paktën kështu e shoh.

Të jetosh me dike që mbart këtë lloj çrregullimi është e vështirë, sfiduese. Sfidë të cilën personi, që kujdeset për një person me autizëm duhet ta kalojë çdo ditë pavarësisht të gjitha pengesave, pa e ditur në do dal fitimtar në fund të ditës. Vëllai im më ka bërë të mundur të kuptoj se nuk ka nevojë të jesh perfekt që të marrësh dashuri, mjafton që dhe me jo perfeksion të dish të falësh.

Është vërtet e vështirë të shkruash për njeriun tënd më të afërt. Mendimet dhe fjalët rrjedhin si lumë por mbase emocionet nëse do arrish të kuptohesh i ndalojnë.

Kur te pyet dikush se cila ka qene dita më e bukur me vëllain tënd, ti fillon mendohesh për të kujtuar atë më të bukurën. Unë nuk kam nevojë të mendohem fare pasi e kam një të tillë në mendje.

Dita kur ai mori pjesë tek Festa e Abetares. Kristi qëndroi bashkë me fëmijët e tjerë gjatë gjithë festës. Unë derdha lot atë ditë, unë që jam dikush që përpiqem ti fsheh emocionet e mia në lidhje me këtë pjesë. Dhe përsëri i fsheha, pasi nuk doja që mamaja ime të lotonte më shumë. Ajo është një person me një tip të ndjeshëm dhe nuk doja ta ngacmoja më shumë me lotët e mi. Por e dini çfarë? Unë jam ndjere krenare, vërtet. Kur ai iu afrua mikrofonit bashkë me shokun e tij edhe pse vëllai im s'mund të fliste, të recitonte vjershën e tij, ashtu si kisha bërë unë në Festën time të Abetares apo si bëjnë të gjithë fëmijët e tjerë, unë përsëri u ndjeva si të kisha kapur qiellin. Ai ishte duke qëndruar atje, në mes të fëmijëve, i qetë. Mendoj se ai po ndihej i lumtur, po e shijonte sipas mënyrës së tij dhe e kuptonte vërtet se kjo ishte Festa që i përkiste atij.

Do e mbaj mend gjatë, por edhe mund ta harroj, pasi vëllai im do dijë të më falë shumë ditë të tjera të lumtura, akoma më të mëdha. Si për të më thënë : "TI KOT NUK THUA QË KE VËLLA TË VEÇANTË, UNË JAM I TILLË, MENDON SE TË VEÇANTËT NDALEN ME KAQ?" JOOOOO

Sara Kotelli

Dialog me prindërit

Ky është djali im, që tani sapo ka bërë 7-vjeç dhe shkon akoma në kopsht. Shokët e tij tani mbarojnë klasën e parë. Çdo të thotë për mua, kur shikoj shokët e djalit që gumëzhijnë kur dalin nga shkolla, kurse unë pres tek dera e shkollës sa të ma sjellin djalit të kapur nga dora. Ai gjithmonë është i shoqëruar nga dikush tjetër.

Në moshën 4-vjeçare mjekët e Qendrës së Zhvillimit në Kombinatin e diagnostikuan me autizëm. Kur ishte 12 muaj ai fliste “mama”, “baba” por me kalimin e kohës këto fjalë jo vetëm që nuk plotësoheshin por u tkurrën në “ma”, “ba”. Në moshën 2 vjeçare kuptova që Genci nuk ishte në të njëjtin stad zhvillimi si bashkëmoshatarët e tij. Përveç fjalëve më shqetësonte edhe fakti që atë nuk e tërhiqte asnjë stimul i jashtëm, nuk pranonte të shoqërohej nga fëmijë të tjerë. Genci nuk ka komunikim verbal, reagon vetëm me anë të gjesteve. Kërkonte të qëndronte vetëm me ne, prindërit e tij dhe nuk shoqërohej nga fëmijë apo njerëz të tjerë. Deri sa mbushi 5 vjeç ai ka qëndruar në shtëpi pasi ne nuk prananim ta dërgonim në kopsht. Çdo ti bënte Gencit Kopshti?!

Kur dëgjuam për projektin që do të fillonte në qytetin tonë, në takimin e parë të prindërve, dëgjova që vajta në kopsht e zhvillon edhe fëmijën me autizëm. Fillova të mendoj dhe në mendjen time u ndez një llambë që ndriçon edhe sot.

Në shtator të 2014 kur e dërguam Gencin në kopsht sjellja e tij filloi të ndryshojë madje filloi të bëhej shqetësuese si për prindërit ashtu edhe për mësuesit apo fëmijët e tjerë. Në fillim e kisha shumë të vështirë të mendoja se ai do të qëndronte në grup më bashkëmoshatarët e tij. Koha po kalonte dhe qëndrimi në grup nga 5 arriti në 30 ose 40 minuta. I ngacmonte shumë fëmijët, duke i marrë lapsat dhe ua thyente, i griste librat. Kur fëmijët fillojnë të këndojnë një këngë Genci mbyll veshët dhe fillon të bërtasë. Si në kopsht edhe në shtëpi ai nuk mund të qëndrojë për një kohë të gjatë në të njëjtin ambient me të njëjtët stimuj. Pëlqen të luaj me formuese por në mënyrë jo funksionale dhe nëse kërkon ta drejtosh apo ta ndihmosh, nuk të lejon, fillon të acarohet, bërtet me zë të lartë dhe qan me të madhe.

Mësuesja e kopshtit me gjithë eksperiencën që kishte në punë me fëmijët nuk mund të më inkurajonte që gjendja e Gencit do të ndryshonte. Falë projektit ne u ulëm të mësojmë të dyja, unë si nënë dhe ajo si mësuese. Lexuam sjellje të ngjashme të fëmijëve të tjerë me autizëm dhe mësuam nga përvoja e shkruar. I vendosëm hapat ngadalë, ngadalë.

Komisioni i ngritur në kopsht për hartimin e PEI (Planit Edukativ Individual) për Gencin së bashku me mësuesen dhe mua hartoi disa objektiva të vogla si p.sh qëndrimi në grup me shokët, vendosja në lojë bashkë me të tjerët duke pasur gjithmonë në krah një shok që e pëlqen. Planifikimi i aktiviteteve bazuar në këto objektiva kërkonte që gjithë stafi i kopshtit të kishte dijeni se si do të punohej me djalit tim Gencin. Pas dy vitesh punë intensive dhe të qëllimshme mund të them se Gencin e kam fituar. Ka tani një komunikim më të mirë me mua, sado që përsëri nuk flet, është më i qetë me shokët, mund të shkëmbejë lodra me ta pa u acaruar, kur do diçka që i pëlqen ngul këmbë, por gjithmonë duke mos lënduar veten dhe shokët. Ja pra çfarë arritëm në dy vite punë të përbashkët. Ai do të qëndrojë mbase akoma në kopsht. Këtë do ta vendosë vlerësimi që do të bëjë komisioni multidisiplinor në DAR. Unë do të realizoj gjithë orientimet që do të më jepen nga komisioni i kopshtit, sepse e pashë me sytë e mij një punë në grup më dha suksese tek Genci. Mbase në një të ardhme do të fitoj më shumë, duke e parë djalit me syrin se çfarë ai ka mundësi të arrijë.

Ligjin “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Vijon nga numri 2

Përkufizime

16. “Nxënës” është personi që arsimohet në arsimin parauniversitar.

17. “Nxënës me aftësi të kufizuara” është personi, i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, që, në ndërvëprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore.

Regjistrimi në klasën e parë/ Dispozitat Normative të Arsimit parauniversitar

NENI 12

Detyrimi shkollor. Identifikimi i fëmijëve të moshës së klasës së parë.

1. Fëmija, që ka mbushur moshën 6 vjeç përfshihet në detyrimin shkollor.

2. Nxënësi që, sipas vërtetimit nga organet e njësisë bazë të qeverisjes vendore, do të qëndrojë jashtë shtetit, nuk përfshihet në detyrimin shkollor për atë kohë sa është jashtë shtetit.

3. Kur prindi nuk i paraqet vërtetimin drejtorit të shkollës publike që nxënësi/fëmija duhet të ndjekë, drejtori e kërkon zyrtarisht vërtetimin të njësisë bazë të qeverisjes vendore. Largimi nga shkolla e nxënësit shënohet në amzën e shkollës. Shihni marrëveshjen e bashkëpunimit “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”

4. DAR/ZA-ja harton një listë të vetme emërore të fëmijëve, që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhëm shkollor, duke ballafaquar të dy listat e ardhura në muajin prill nga zyra e gjendjes civile dhe qendra shëndetësore. DAR/ZA-ja e dërgojnë këtë listë të gjitha shkollave në juridiksion (publike, private) brenda muajit maj.

5. Në fund të periudhës së regjistrimit në shkollat publike, drejtorët e shkollave bazë publike dhe ato private i dërgojnë DAR/ZA-së listat emërore të fëmijëve të regjistruar

në shkollat e tyre.

6. DAR/ZA-ja harton listën e re të fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollat bazë publike dhe ato private në juridiksionin e tyre dhe, brenda muajit shtator, e dërgon këtë listë kryeplakut përkatës të zonës dhe inspektorit të policisë së zonës.

7. Kryeplaku dhe inspektori i policisë gjen në listën e fëmijëve ende të paregjistruar, që i dërgohet nga DAR/ZA-ja, fëmijët që i përkasin zonës që mbulon dhe duhet të regjistrohen në klasën e parë në një shkollë të DAR/ZA-së. Emrat e fëmijëve shoqërohen me vendndodhjet e tyre.

8. DAR/ZA-ja, deri më 15 tetor, i dërgon shkollave publike të dhënat e kryepleqve dhe të inspektorëve të policisë së zonës.

9. Shkollat publike identifikojnë fëmijët, që u përkasin zonës së tyre dhe, deri në fund të muajit tetor të vitit të ri mësimor, marrin përsipër regjistrimet e nxënësve dhe informojnë zyrtarisht DAR/ZA-në përkatëse.

10. DAR/ZA-të dhe shkollat bashkëpunojnë me OJF-t, që veprojnë në fushën e arsimit, për zbatimin e LAPU-s për detyrimin shkollor.

NENI 13

Procedurat e regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë.

1. Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë të shkollave publike bëhet në dy javët e fundit të muajit qershor.

2. Në gjashtë ditët e para kanë të drejtë të regjistrohen në klasën e parë të një shkolle publike vetëm nxënësit që i përkasin zonës së shkollës. Kur largesa e banesës së fëmijës nga dy shkolla publike është e diskutueshme, prindi zgjedh njërin nga të dyja shkollat. Në katër ditët pasuese kanë të drejtë të regjistrohen edhe nxënës që u përkasin shkollave të zonave të tjera. Regjistrime të veçanta pranohen deri ditën para fillimit të vitit shkollor.

3. Regjistrimi i fëmijës në klasën e parë bëhet me këto dokumente:

- a) Certifikata e lindjes e fëmijës.
- b) Vërtetimi i vaksinimeve nga qendra shëndetësore.
- b) Raporti nga okulisti.
- c) Adresa e fëmijës;
- ç) Vërtetimi i ndjekjes së kopshtit sipas grupeve, i firmosur nga drejtoresha e kopshtit (nëse ka).

4. Në raste të veçanta, kur prindi dëshiron të regjistrojë fëmijën në klasë të parë, por nuk disponon certifikatën e lindjes ose/dhe vërtetimin e vaksinimeve veprohet si në rastet analoge me kopsht/

Kalendari i aktivitete

Vizitë studimore në Bolonjë

Në kuadër të projektit “Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri” Save the Children në partneritet me Universitetin e Bolonjës në Itali organizuan vizitën studimore e cila u zhvillua në Bolonja nga data 1 deri në 5 shkurt 2016.

Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimin i eksperiencave të institucioneve përgjegjëse për edukimin e personave me Aftësi të Kufizuar siç është Ministria e Arsimit dhe e Sportit dhe institucionet në varësi të saj, si dhe institucionet përgjegjëse për gjithëpërfshirjen sociale të personave me Aftësi të Kufizuar siç është Ministria e Punës e Mirëqenies Sociale dhe Rinise dhe institucionet në varësi të saj.



Në kuadër të kësaj vizite studimore, zyrtarë të ftuar nga fusha sociale dhe e edukimit patën mundësinë të shohin drejtpërdrejtë funksionimin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës në shkollat dhe universitetet mikpritëse si dhe strukturat që lehtësojnë dhe mundësojnë aksesin dhe gjithëpërfshirjen sociale të personave me Aftësi të Kufizuar, duke mundësuar zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre dhe duke siguruar mirëqenie të plotë përmes ofrimit të mundësive për autonomi personale dhe pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe kulturore të çdo fëmije.

Të ftuar në këtë vizitë studimore ishin: Drejtoresha e Arsimit Parauniversitar në MAS, Këshilltar i Ministrit në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, profesorë të Universitetit të Korçës dhe Elbasanit, si dhe përfaqësues nga shoqata e prindërve të personave me aftësi të kufizuar MEDPAK dhe Save the Children.

Vizita studimore në Kosovë

Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimin i eksperiencave midis Ministrive të Arsimit dhe institucioneve shkollore për gjithëpërfshirjen sociale të nxënësve me Aftësi të Kufizuar në shkollat e zakonshme dhe shkëmbim i përvojave.

Në kuadër të kësaj vizite studimore, zyrtarë të ftuar nga fusha sociale dhe e edukimit patën mundësinë të shohin drejtpërdrejtë funksionimin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës në shkollat dhe universitetet mikpritëse si dhe strukturat që lehtësojnë dhe mundësojnë aksesin dhe gjithëpërfshirjen sociale të personave me Aftësi të Kufizuar, duke mundësuar zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre dhe duke siguruar mirëqenie të plotë përmes ofrimit të mundësive për autonomi personale dhe pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe kulturore të çdo fëmije.



Të ftuar në këtë vizitë studimore ishin: specialistë të drejtorisë së Arsimit Parauniversitar në MAS, drejtues të shkollave dhe kopshteve të përfshira në projekt, pedagogë nga universiteti i Korçës dhe Elbasanit që merren me përgatitjen e mësuesve të rinj, si dhe përfaqësues nga shoqata e prindërve të personave me aftësi të kufizuar MEDPAK dhe Save the Children.

Fushata #UnëMbretFëmijët

Në këtë fushatë të iniciuar nga Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nisi një plan mobilizimi me moton **#unëmbrojtëmijët**. Pjesë e këtij plani mobilizimi u bë edhe MEDPAK. Në këtë fushatë MEDPAK në të 9 rajonet ku punon u bashkua me njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në bashkitë përkatëse dhe organizoi aktivitete ndërgjegjëse për mbrojtje e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.



Në Aktivitetin e mbylljes që u organizua në datë 1 Qershor, MEDPAK në Partneritet me shoqatën Dawn Sindrom Albania organizoi një bashkëbisedim me student dhe pjesëmarrës të komunitetit me temën **Arsimi gjithëpërfshirës në Shqipëri, arritje dhe sfida**. Dëgjuesit gjatë takimit drejtuan shumë pyetje dhe qartësuan të drejtën për arsim edhe të fëmijëve me aftësi të kufizuar

1 Qershori

Në kuadrin e festës së 1 Qershorit në disa nga rajonet ku ne punojmë u organizuan festime për fëmijët në bashkëpunim edhe me institucione të tjera në këto bashki.

✓ Në Vlorë në partneritet me DAR , u organizua për të gjithë fëmijët e kopshteve në Vlorë aktiviteti “ MburoBuzëqeshjen time”.



✓ Në kuader të 1 Qershorit, shkolla “31 Korriku”, “Ali Metra” dhe Kopshti nr.2, Burrel, me mbështetjen e MEDPAK dhe Save the Children kanë organizuar aktivitete festive dhe sensibilizues për gjithëpërfshirjen, ku u bë edhe shpërndarja e 600 fletëpalosjeve që lidhen me prindërimin pozitiv.



✓ Duke u nisur nga parimi i gjithëpërfshirës në datë 1 Qershor, në ditën e fëmijëve, në Peshkopi në bashkëpunim me qeverinë e nxënësve, në kuadrin të projektit që po zbatohet nga MEDPAK dhe Save the Children, u organizua aktiviteti nga shkolla, ku përsëri në fokus ishte arsimi gjithëpërfshirës.